



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS
KËSHILLI KOMBËTAR I RESTAURIMEVE

Nr. 262 Prot.

Tiranë, më dt. 31.05.2018

VENDIM

Nr.230, dt. 31.05.2018

Në mbështetje të nenit 47 të Ligjit nr.9048, datë 07.04.2003, “Për Trashëgiminë Kulturore”, i ndryshuar, Këshilli Kombëtar i Restaurimeve, në mbledhjen e datës 31.05.2018, pasi shqyrtoi projektin e diskutuar më parë dhe në Këshillin Shkencor të Institutit të Monumenteve të Kulturës,

VENDOSI:

1. Miratimin e rishikimit të Vendimit Nr.176, dt.18.04.2018 për projektin: “Ndërtimi i linjës 10 KV në territorin e njësisë administrative Maliq, në fshatin Tudas, Denas dhe Osojë, Qarku Korçë”, me subjekt aplikues “Devoll Hydropower” sh.a.
-Gjatë zbatimit, kabina elektrike në afërsi të “Kishës së Shën Triadhës (Tudasit)”, duhet të ruhet në volume dhe në imazh.
2. Shoqëria të kontribuojë për restaurimin e objektit monument kulture: “Kisha e Shën Triadhës (Tudasit) në fshatin Lavdar të Oparit”, Korçë.
3. Gjatë procesit të zbatimit, siç parashikon dhe legjislacioni për trashëgiminë kulturore, punimet të **mbikëqyren** sipas nenit 48 të ligjit nr. 9048, dt. 07.04.2003 “Për Trashëgiminë Kulturore”, i ndryshuar.
4. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR

Mirela Kumbaro Furxhi



SEKRETARI KKR

Arta Dollani